UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

FAKULTETI I SHKENCAVE DHE TEKNOLOGJIVE
BASHKEKOHORE

IMPAKTI I EKSPOZIMIT TË NXËNËSËVE NË TIK DHE EFEKTI I SAJ NË MËSIMNXËNIE

PUNIMI I MAGJISTRATURËS

Kandidati:
Erëmirë Zogaj - Xhemajli

Mentori:
Bujar Raufi

Deklaratë e autorit

Unë deklaroj nën përgjegjësi të plotë se ky punim është shkruar prej meje, nuk është prezantuar asnjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar i tëri ose pjesë të veçanta të tij. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër përveç rasteve të cituara dhe referuara.

Erëmirë Zogaj Xhemajli

_____

Falënderime

Falënderim të veçantë kam për prof. Bujar Raufi, të cilin e çmoj shumë për durimin që pati për diskutimet, këshillat dhe rekomandimet që më dha për ta përfunduar këtë punim magjistrature.

Një falënderim të veçantë kam për nxënësit dhe mësimdhënësit e komunës së Lipjanit, pjesmarrës në hulumtim, të cilët më ndihmuan në mbledhjen e të dhënave për qëllimet e këtij punimi.

Së fundmi, jam shumë mirënjohëse ndaj familjes time për gjithë mbështetjen, durimin dhe mirëkuptimin që më kanë dhënë për të realizuar dhe përfunduar me sukses këtë punim.

Abstrakt

Qëllimi i kryesor i këtij punimi është të hulumtojë dhe gjejë rezultatet që ka ekspozimi i nxënësëve në TIK dhe ndikimi i tij në performancën e tyre apo në mësimnxënie. Në këtë punim janë përmbledhur të gjeturat kryesore nga shfletimi i literaturës, rezultatet nga pyetsorët me mësimdhënës dhe nxënës, eksperimenti me testim i një grupi të nxënësëve. Në këtë mënyrë kemi tentuar të japim disa këndvështrime për të nxjerrur rezultate sa më të sakta dhe sa më të përgjithshme.

Pjesë e ketij hulumtimi kanë qenë 200 nxënës dhe 30 mësimdhënës të shkollave të mesme të larta të komunës së Lipjanit.

Hulumtimi sygjeron se përdorimi i TIK-ut në mësimdhënie/mësimxënie jo vetëm për faktin që tashmë nuk mund t'i shmanget por edhe për lehtësirat dhe mundësitë e mëdha që ofron, pra duhet të gjendën mënyra që integrohet në mënyrë sa më të mirë të mundëshmë dhe se nuk duhet lënë anash asnjëherë mbështetja dhe motivimi i vazhdueshëm i nxënësëve dhe mësimdhënësëve në mënyrë që nxënësit tanë tanë të mos mbesin prapa po të jenë pjesë e pandashme e kohës dixhitale që po jetojmë.

Fjalët kyçe

Përdorimi i TIK, performanca e nxënësëve, nevojat e mësimdhënësëve

Abstract

The main purpose of this paper is to research and find out the results that students' exposure has and its impact on their performance or learning. This paper summarizes the main findings from the literature review, the results from the questionnaires with teachers and students, the experiment with testing of a group of students. In this way we have tried to give some perspectives to get the most accurate and general results.

Part of this research were 200 students and 30 teachers of high schools in the municipality of Lipjan.

Research suggests the use of ICT in teaching/learning not only because it can no longer be avoided but also because of the great facilities and opportunities it offers, therefor we must find ways to integrate as best as possible and that the constant support and motivation of students and teachers should never be neglected so that our students do not lag behind if they are an integral part of the digital time we are living.

Keywords

ICT use, student performance, teacher needs

Përmbajtja

Deklaratë e autorit 2

Falënderime 3

Abstrakt 4

1.Hyrje 7

1.1.Mënyrat e përdorimit të teknologjisë në përmirësimin 8

e mësimdhënies/mësimnxënies 8

2.Qëllimet e hulumtimit 10

3. Hipotezat 11

4.Analiza e literaturës 12

5.Disponueshmëria e TIK-ut në ambientet shkollore 19

5.1 Gjendja e tanishme ne shkollate e Mesme të Lipjanit 19

5.2 Propozim i dizajnit 19

6.Mënyrat për motivimin e mësimdhënësve që të përdorin TIK në procesin mësimor 22

6.1 Nevojat e mësimdhënësëve 23

6.2 Ku janë gabimet 23

6.3 Kultivimi i zhvillimit profesional 24

7.Analiza e impaktit të ekspozimit të nxënësve në TIK 27

7.1Analiza e testit të nxënësëve të ekspozuar dhe joekspozuar në TIK 27

7.2 Analiza e pyetësorit të nxënësëve 28

7.3 Analiza e pyetësorit të mësimdhënësëve 35

8.Diskutimi i rezultateve 42

9.Përfundim 45

Referencat 47

Shtojca 1: Pyetsor me mësimdhënës rreth përdorimit të TIK gjatë procesit mësimor 50

Shtojca 2: Pyetsor me nxënës rreth përdorimit të TIK gjatë procesit mësimor..... 53

1.Hyrje

TIK në edukim ka shumë përparësi, më e rëndësishmja është se TIK-u zhduk barrierat të kohës dhe vendit. Përzgjedhja e TIK-ut në mes tjerash bëhet për shpejtësinë, saktësinë, kapacitetin e lartë të ruajtjes së të dhënave, integritetin, konsistencën, qëndrueshmërinë dhe mbi të gjitha karakteristikës së veçantë, ndërveprimit që ofron.

Comment [BR1]: Ruajtjtes së çkahit?!?!

Në këtë punim të magjistraturës prezentohen çështjet dhe konceptet kryesore që duhet të konsiderohen për efektin që jep ekspozimi i nxënësëve në TIK (Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit) në sistemin edukimit. Përparësitë që ofrohen kur bëhet përfshirja e këtyre zhvillimeve teknologjike gjatë procesit të mësimnxënies si dhe dobësitë eventuale që mund të hasen.

Në vendin tonë ende ka mungesë të konsiderueshme të digjitalizimit në shkolla dhe për pasojë edhe mungesë të përfshirjes së aplikacioneve dhe platformave ekzistuese të cilat do të lehtësonin dukshëm të kuptuarit e përmbajtjeve të ndryshme mësimore në lëndët e ndryshme të parapara me kurrikulë.

Disponueshmëria dhe identifikimi i infrastrukturës së përshtatshme për mbështetjen e vendosjes së TIK-ut në shkolla, është një sfidë e madhe me të cilën ballafaqohen aktualisht shkollat në vend prandaj edhe kjo do të jetë një pjesë e rëndësishme e këtij punimi.

Të mësuarit dixhital fillon me mësuesit, performanca e të cilëve zgjerohet me ndihmën e teknologjisë dhe jo në ndonjë mënyrë tjetër.Teknologjitë e reja në klasë janë menduar për të shtuar angazhimin e nxënësëve dhe për të lehtësuar punën e mësuesve. Por, mungesa e njohurive, mësimdhënësëve do të ju krijonte shqetësime dhe pasiguri në vend se ata të ndiheshin më të lehtësuar.

Aspekt tjetër po aq i rëndësishëm është mbështetja e mësimdhënësëve për të përdorur në mënyrë sa më efikase këto teknologji do të jetë pjesë e këtij hulumtimi. Nëse mësuesit do të ishin në gjendje për shfrytëzimin e drejtë të teknologjisë do të rezultonte në gjenerata të reja që janë të pajisura me dije, performancë të shkelqyer dhe konkurent në botën bashkëkohore. Hulumtim i këtij punimi është pikërisht identifikimi dhe potencimi i të gjitha përparësive të TIK të cilat do të përmbushnin kërkesat e institucionioneve arsimore.

1.1. Mënyrat e përdorimit të teknologjisë në përmirësimin e mësimdhënies/mësimnxënies

Përderisa teknologjia çdo ditë e më shumë bëhet pjesë e jetëve tona dhe sjell lehtesira, ajo nënkuptohet që është edhe pjesë e pandashme e mësimdhënies dhe mësimnxënies duke ndihmuar në efikasitetin e tyre në çdo lëndë

Ekzistojnë shumë mënyra përdorimi me anë të të cilave do të mund të kemi impakt pozitiv të TIK në mësimdhënie dhe nxënie. Si përdoret teknologjia varet nga shumë faktor, të tilla si resurset financiare në dispozicion të shkollës, njohuritë në përdorimin e këtyre teknologjive nga ana e stafit të shkollës.

Mjetet e ndryshme për prezentim, videot dhe interneti kanë ndikime të ndryshme në përceptimin e të mësuarit dhe motivimin e nxënësëve. Ndaj një mësues duhet të përdor teknologji të ndryshme në klasë dhe të përdor ato në mënyrë kreative në mënyrë që të përmbush kërkesat e të nxënit dhe objektivat mësimore.

Një ndër aplikacionet që është përdorur ka kohë dhe vazhdon të përdoret është edhe Power Pointi. Ky është një program që u mundëson nxënësëve dhe mësuesve të përgatisin prezentime të ndryshme. Kur përdoret në mënyrë efektive, Power Point mund të përmirësoj me të vërtetë prezentimet e ligjeratave të ndryeshme po ashtu edhe të kuptuarit nga ana e nxënësëve se sa thjesht përdorimi i dërrasës së zezë.

Power point është shumë i popullarizuar sepse mësohet lehtë dhe është gjerësisht i disponueshëm. Ofron mundësinë për të përfshirë në prezentimet tona lloje të ndryshme të mediave, imazhe, animacione dhe shumë më tepër. Kjo rrit aftësinë e nxënësëve për të mbajtur mend, në veçanti për nxënësit që kanë prirje për të mësuar në mënyrë vizuale, njëkohësisht ofron kohë shtesë për bashkveprim në mes nxënësëve dhe mësimdhënësëve.

Power point nuk është aplikacion vetëm për mësimdhënësit, ai ndihmon gjithashtu edhe nxënësit për krijimin e prezentimit të tyre duke ndihmuar edhe në zhvillimin e kreativitetit si dhe aftësisë për të folur në publik.

Ashtu si në çdo teknologji, mënyra se si përdoret Power Point e përcakton efektivitetin pedagogjik. Duke përdorur pikat strategjike të përshkruara më lart Power Point mund të përdoret për të përmirësuar të mësuarit dhe angazhimin e nxënësëve. Fuqia e Power point mund të rritet vetëm duke u ndërthurur me nevojat e nxënësëve dhe teknikat fleksibile dhe të efektshme të mësimdhënies.

Përdorimi i animacioneve nga programet e ndryshme kompjuterike ndihmon shumë në sqarimin e përmbajtjeve sidomos në lëndët shkencore.

Gjithashtu, hulumtimi i informacioneve në internet në çdo kohë dhe vend, 24/7 është një mundësi e madhe për t'u shfrytëzuar nga të dy palët, nxënësit dhe mësimdhënësit, në përgaditjen e përmbajtjeve mësimore, sidomos kur kemi parasysh që librat shkollor përdoren për vite me radhë, ndërkohë që materijalet që ofrohen në internet mund t'i gjejmë të përditësuara me gjetjet e fundit shkencore apo të përshtatura me trendet e zhvillimeve teknologjike.

Posta elektronike dhe Interneti poashtu përdoren për komunikim. Kjo përfshin forma të ndryshme të komunikimit, nxënësëve mes veti, nxënësëve me mësimdhënës, mësimdhënës me mësimdhënës. Ky komunikim lehtësohet prej platformave të shumta dhe të ndryshme që sot janë në dispozicion. LMS mund të ofrojë mësuesve beneficione të shumta, të cilat e rrisin përvojën e mësimdhënjes dhe e bëjnë më efektive. Disa nga efikasitetet e shtuara:Të gjitha komunikimet me nxënës përfshirë edhe vrejtjet për detyra dhe nota janë në një vend. Reduktojnë përdorimin e letrës, shtimi, heqja, ruajtja dhe fshirja e materialeve të lëndës në kuadër të hapsirës së kursit. Studentët kanë qasje 24 ore në ditë, 7 ditë në javë në postime, resurse, njoftime, nota etj. Nxënësit që mungojnë mund të kontrollojnë përditësimin e përmbajtjeve, oraret dhe njoftimet, pa i kërkuar këto të dhëna në mënyrë individuale. Nxënësit mund të shohin informacionet aktuale të tilla si linqet në web sajt, artikuj, video dhe multimedia tjera.

Mundësia e qasjes në vegla të web konferencave. Mësuesit planifikojnë oraret e punës, aktivitetet dhe ngjarjet e veçanta, aktivitetet në grupe të vogla dhe sesionet studimore. Kështu nxënësit mund të marrin pjesë në këto ngjarje të planifikuara, ndërsa ata të cilët nuk ju përshtatet orari mund të shohin regjistrimet e aktiviteteve. Ka disa mënyra që mësuesit dhe shkollat mund të zbatojnë sistemet e menaxhimit të të mësuarit.

Web faqet zyrtare të shkollave mund të përdorur jo vetëm për postime të informacioneve gjenerale te një audiencë e caktuar, por gjithashtu edhe për koleksionimin e postimeve si nga ana e mësimdhënësëve poashtu edhe nga nxënësit.

Edukimi në distancë mund të ofrojë lehtësime të shumta, sidomos për nxënësit që për arsye të ndryshme nuk janë në gjendje të ndjekin procesin mësimor.

2.Qëllimet e hulumtimit

Zhvillimi kaq i shpejtë dhe me këto përmasa i teknologjisë ka sjellë mundësi të mëdha për lehtësimin e jetës sonë në çdo fushë të jetës. Prandaj edhe nevoja për njohje dhe përdorim të saj është çdo ditë edhe më e madhe.

Qëllimi kryesor i këtij punimi është të investigoj rolin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunimimit (TIK) për të përmirësuar performancën e nxënësëve tanë si dhe ambijentit mësimor, të identifikojë burimet e përshtatshme të TIK-ut në procesin e mësimdhënies si dhe identifikimi i problemeve të mundshme në përdorimin e TIK në funksion të arritjes së rezultateve të synuara të kurrikulës nga ana e mësimdhënësëve në klasë.

Analiza e impaktit të TIK-ut në mësimnxënie paraqet nje punim të rëndësishëm se pse përmes këtij hulumtimi do përcaktohet impakti direkt i mësimnxënies përmes TIK-ut dhe krahasuar me ata nxënës të cilët nuk janë të ekspozuar ndaj këtyre metodave të reja të mësimdhënies dhe mesimnxënies.

Qëllimi i hulumtimit fokusohet në këta pika kryesore.

- Të investigoj impaktin direkt të TIK-ut në procesin e mësimnxënies tek nxënësit.
- Të përcakton sa është ky impakt krahasuar me nxënësit të cilet nuk janë ekpozuar në TIK dhe metodat e reja të mësimdhënies dhe mësimnxënies.
- Të analizon rezultatet nga grupet krahasuese dhe të gjeneron rekomandime të nevojshme lidhur me ndikimin e TIK-ut tek mësimnxënia.

3. Hipotezat

Hulumtimi bazohet në hipotezat e mëposhtme:

1. Ekspozimi i nxënësëve në TIK ka shumë efekt pozitiv në procesin e mësimnxënies krahasuar me nxënësit e po të njëjtit vit që nuk janë të ekpozuar në te.
2. Qasja në burimet e ofruara nga TIK është shumë e rëndësishme në procesin e mësimdhënies dhe konrtibion direkt tek mësimnxënia.
3. Përdorimi i metodave të ndryshme të TIK-ut në mësimdhënie nga ana e mësimdhënësëve ndikon direkt tek mësimnxënia.

4.Analiza e literaturës

TIK është një vegël shumë e fuqishme për promovimin e mundësive edukative. Ai transformon procesin e mësimdhënies e mësimnxënies me përfshirjen e elementeve më atraktive në ambientin mësimor. Mësimdhënia dhe mësimnxënia në ditët e sotme bazohet në hulumtim, në të menduarit kritik dh e zgjerim të dijeve, përderisa nxënësit mund të kenë qasje në burime të ndryshme dhe shumë të pasura të marrjës së informacionit. Gjithashtu, TIK ndihmon në kuptimin e koncepteve komplekse, përmes simulimeve të situatave të ndryshme, modifikimit të materialeve dhe aktiviteteve varësisht nga kërkesat dhe aftësitë individuale të nxënësëve, veçanarisht duke dhënë feedback të personalizuar.

Meqë teknologjia e Informimit dhe Komunikimit ka përfshirë jetën tonë në të gjitha sferat, padyshim që fokus i studimeve të dekadave të fundit ka qenë edhe impakti që ka në fushën e edukimit apo se si e sa ndikon ekspozimi i nxënësëve në TIK në performancën e tyre gjatë procesit të mësimnxënies.

Gjatë këtyre hulumtimeve të bëra studiuesit kanë hasur vështirësi për të dhënë përgjegje empirike dhe teorike pasiqë performanca e nxënësëve është vështirë për t'u vëzhguar dhe gjithashtu që nxënësit të mund të izoloheshin nga ekspozimi në TIK.

Përderisa shkollat kanë bërë investime të mëdha në paisje të ndryshme të cilat mundësojnë përdorimin e TIK nga ana e nxënësëve dhe mësimdhënësëve, kjo padyshim që ka sjellë ndryshime të mëdha në edukim, ka sjell ndryshime në mënyren e qasjes në informacion, fitim të shkathtësive dhe kompetencave të reja, aftësive bashkpunuese etj.

Ndikimi i TIK-ut në mësimnxënie është shumë i rëndësishëm dhe kërkon vëmendje poaq sa edhe kurrikula. Vëzhgimi i rezultateve të përmirësuara është bazuar në: motivimin, knaqësinë e të mësuarit, vetvlerësimin, aftësitë bashkëpunuese, njohuritë lëndore, trajtimi i informacionit etj.

Përdorimi i teknologjive të reja është gjithnjë e më intenziv por mungesa e një strategjie në lidhje me ndryshimin organizativ,sipas disa studimeve, çon në një ndikim të dobët të TIK-ut në përformancën e nxënësëve (Ben Youssef & Dahmani, 2008).

Comment [BR2]: Ju kam shkruar disa here se referenca NUK GUXON te kete ne fusnota. Pra funsota nuk duhet te kete aspak. Ato duhet te jene te referencuar ne tekst (sipas udhezuesit). Nese keni APA style do jete (Mbiemri I autorit, viti). Lko vlen për çdound k uke përdorur fusnota.

TIK mund të sigurojë resurset dhe kornizat pedagogjike për të ju mundësuar nxënësëve të bëhen efektiv dhe të pavarur (Tezci, 20011). Shembull, programet kompjuterike në dispozicion mund të përshtaten me nivelin e nxënësëve dhe pastaj vendosin detyrat e përshtatshme si dhe vrejtjet për performancën. Përdorimi racional, mund të ju ndihmoj nxënësve për rezultate më të mira. Kur lëndët e përfshira në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit (TIK) janë mësuar mirë, kanë treguar rritjen e shkallës së kuptueshmërisë dhe të arriturave të nxënësëve në lëndët përkatëse. Kjo për arsye se TIK "i vërtetë" është

më shumë për aftësitë e të menduarit se sa për zotërimin e softuerëve të veçantë(Biggs, J.B, 2003). Hulumtime të shumta, sistematike, mbi 30 vite, kanë identifikuar që cilësia e të mësuarit të nxënësëve është e lidhur me atë se çka janë duke mësuar nxënësit, si i qasen mësimeve të tyre dhe si e përceptojnë kontekstin e të mësuarit. Hulumtimet kanë treguar se kjo është e lidhur edhe me përceptimin e mësuesëve për të mësuarit të nxënësëve, si e konceptojnë mësimdhënien dhe si ata qasen në eksperienca të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Rezultatet kryesore sygjerojnë(Biggs, J.B, 2003):

- Jo të gjithë nxënësit arrin eksperiencat e dëshiruara, edhe pse pregaditen në të njejtën mënyrë nga mësuesit;
- Kualiteti i eksperiencave të fituara nga nxënësit është i lidhur me qasjet e ndryshme të përshtatura nga mësuesit në mësimdhënie;
- Cilësia e të mësuarit mund të vlerësohet duke përdorur instrumentet përkatëse në përfundim të ligjerimit të lëndës.

Studime të shumta gjithashtu u fokusuan në përdorimin e teknologjisë në edukim. Teknologjia duhet të përdoret më shumë se sa në mbështetjen e metodave tradicionale(IEEE Learning Technology Standards Committee[LTSC],2001). Mësuesit duhet të mësojnë jo vetëm se si të përdorin teknologjinë për të përmirësuar mësimdhënien tradicionale apo për rritjen e produktivitetit, por gjithashtu duhet të mësohet nga përspektiva nxënësi në qendër, si TIK mund të integrohet në aktivitetet e klasës për promovimin e të mësuarit të nxënësëve. Kjo do të thot se mësuesit duhet të përdorin TIK në mënyra më kreative dhe produktive për rritjen e angazhimeve dhe aktiviteteve dhe mësimeve më efektive. Hence, Castro Sanchez dhe Aleman sygjerojnë që mësuesit duhet të jenë të hapur ndaj integrimit të TIK në klasë. Është e domosdoshme që mësuesit të mësojnë strategji të reja të mësimdhënies për adaptimin në veglat e reja gjatë mësimdhënies me teknologji. Mësimdhënësit përdorin TIK-un më shumë për përgaditjen e testeve se sa për të nxitur mendimin kritik(IEEE Learning Technology Standards Committee[LTSC],2001). Në mënyrë të ngjashme, Palak dhe Muret gjeti se mësuesit kryesisht përdorin teknologjinë për të mbështetur qasjet e tyre ekzistuese të mësimdhënies dhe më rrall për të nxitur të mësuarit me qendër nxënësin(Palak, D & Walls, R. 2009) . Sipas autorëve, një shpjegim i mundshëm është mungesa e modeleve se si të përdorin teknologjinë për lehtësimin e të mësuarit dhe kufizimet e lidhura me faktorët kontekstual si madhësia e klasës dhe aftësia e studentëve. Më tej, Brush, Glazewski dhe Hew , gjetën se pregaditja paraprake e mësuesve nuk siguron njohuri të mjaftueshme për të mbështetur përdorimin e teknologjisë, nuk demostron metodat e duhura për integrimin e teknologjisë në kurikula(Brush & Glazewski &Hew, 2008).(Më shumë trajnime duhet të sigurohen për parapërgaditje të mësuesve në mënyrë që të bëhet integrimi efektiv i teknologjisë në klasë . Për të ndihmuar mësuesit që të përballen me këto vështirësi, Chen sygjeron që në vend se të sigurohen vetëm teoritë, hulumtuesit e TIK duhet të ofrojnë shembuj të dokumetuar se si mësuesit do të bëjnë

integrimin e teknologjisë në mënyrë efektive për të përmbushur nevojat dhe qëllimet e tyre pedagogjike(Chen, 2008). Sistemi i menaxhimit të të mësuarit (LMS) është e specializuar si Teknologji e sistemeve Mësimore, bazuar në Internet dhe WWW për të siguruar edukimin dhe trajnimin me standardet e hapura të të mësuarit në distance(Blurton, 2002). Hartimi dhe zbatimi i sistemeve të tilla nuk është detyrë e lehtë, pasi që kemi të bëjmë me teknologji komplekse që përfshijnë shumëllojshmëri të komponenteve organizative, administrative, mësimore dhe teknologjike.

Në përgjithësi hulumtimet sygjerojnë se TIK-u mund të ndihmojë në mënyrë të fuqishme nxënësit dhe mësuesit, të promovojnë ndryshime dhe të nxisin aftësitë dhe shkathtësitë e domosdoshme për kohën që jetojmë. Ndihmon që fokusi gjatë procesit të mësimdhënies/mësimnxënies të kalojë nga mësimdhënësi te nxënësi në qendër, transofrmim ky që rezulton në ofrimin e mundësive më të mëdhaja krijuese, zhvillim të mendimit kritik, aftësive komunikuese,kreativitetin e tyre, zgjidhje më të lehtë të problemeve etj.

Poashtu, TIK nuk shihet si thelbësor në procesin e përgjithshëm të mësimdhënies. Ndërthurja e duhur e planeve mësimore dhe vënja e TIK-ut në shërbim të arritjes së rezultateve është thelbësore në procesin edukativ. TIK është joefektiv nëse qëllimet pse përdoret nuk janë të qarta. TIK përdoret në mënyra të ndryshme nëpër lëndët e ndryshme në shkolla. Kur TIK-u përdoret për simulime dhe modelime shkencore, është shumë efektiv poashtu edhe në lëndët për mësimin e gjuhëve apo edhe për përgaditjen e prezentimeve të ndryshme.

Impaktet pozitive në përdorimin e TIK në edukim, janë të vështira për t'u matur edhe pse për këtë temë janë bërë hulumtime të shumta. Gjithashtu këtu duhet pas parasysh edhe ekspozimi në TIK i nxënësëve gjatë procesit mësimor në klasë dhe jashta klasës. Nxënësit që kalojnë më shumë kohë në përdorimin e teknologjisë pas orarit mësimor bazuar në praktikat tona, kanë rezultate më të dobëta për arsye se ky përdorim i teknologjisë bëhet për përdorimin e rrjeteve sociale apo lojrave kompjuterike e shumë pak në zgjidhjen e detyrave shkollore apo për hulumtime dhe gjetje të informacioneve që kanë të bëjnë me detyrat e kërkuara në klasë.

Përdorimi i teknologjisë në procesin arsimor nuk është i mjaftueshëm për të siguruar integrimin e TIK në klasë pasi teknologjia e vetme nuk sjell ndryshime. Përkundrazi mënyra se si mësimdhënësit e përdorin atë ka potencial për të sjell ndryshime dhe për të pas impakt në performancën e nxënësëve.

Pa dyshim se për impakt pozitiv të teknologjisë te nxënësit duhet ditur se a përdoret drejt nga ana e mësimdhënësëve apo thënë ndryshe sa mësimdhënësit kan arritur ta zotërojnë teknologjinë dhe ta ndërthurin me kurikulën dhe me arritjen e rezultateve të kërkuara mësimore. Përndryshe nuk do të kishte kuptim të thuhej nëse ndikon për mirë apo për keq aplikimi i TIK te nxënësit.

Përdorimi i përditshëm i TIK në klasë kërkon kohë dhë përgaditje sistematike. Poashtu mbështetja e mësimdhënësëve dhe inkurajimi për të përdorur TIK-un është detyrë komplekse dhe që varet nga shumë faktor(personale, teknike, pedagogjike etj). Sipas studimeve të ndryshme, dështimet që ndodhin në përdorimin e teknologjisë nga ana e mësimdhënësëve është rrjedhojë e programeve të papërshtatshme të përgaditjes së mësimdhënësëve e që bazohen në aspekte teknike dhe injorojnë çështjet thelbësore ato që lidhen me pedagogjinë(Mishra & Kohler, 2005).

Fokusi i këtij studimi ishin tri elementet themelore të fushave të njohurive: Përmbajtja, pedagogjia dhe teknologjia. Përmbajtja janë lëndët që mësohen p.sh Matematika, Historia etj. Teknologjia përfshinë teknologjinë e përdorur si kompjuterët, Interneti, projektorët etj. Pedagogjia përshkruan praktikat, proceset, strategjitë, procedurat dhe metodat e mësimdhënies/mësimnxënies.

Përfundimisht nëse konsiderohen të tri këto elemente do të mund të marrim njohuri teknologjike pedagogjike të përmbajtjes. Integrimi i vërtetë i teknologjisë është të kuptuarit dhe ndërthurja midis këtyre tre elementeve përbërëse të njohurive (Mishra & Kohler, 2005).

Comment [BR3]: Keshtu duhet te jete referencimi duke shtuar edhe vitin)

Modeli i pranimit të teknologjisë (Technology Acceptance Model-TAM, është një model që ka për qëllim të përshkruaj se si besimet individuale ndikojnë në përdorimin e suksesshëm të teknologjisë(Davis, 1989).

Konkretisht, TAM analizon marëdhëniet mes katër parametrave themelorë që përcaktojnë lidhjen mes individëve dhe sistemeve teknologjike: Dobia e përceptuar, lehtësia e përdorimit, përputhshmëria dhe qëndrimi ndaj përdorimit.

Dobia e përceptuar nënkupton se sa një mësimdhënës beson ose konsideron se teknologjia do të përmirësonte përformancën e tij. Sa më e lartë është dobia e përceptuar, aq më shumë mësimdhënësi do të adaptojë teknologjinë e re.

Lehtësia e përceptuar i referohet shkallës në të cilën një individ beson se një teknologji është e lehtë për tu kuptuar dhe përdorur ose do të përdorej lehtë pa përpjekje shtesë.

Përputhshmëria, nënkupton shkallën në të cilën një teknologji përshtatet me vlerat dhe përvojat e mundshme ekzistuese të përdoruesve. Një teknologji e re adaptohet më lehtë nëse përputhet me detyrat e punës dhe sistemin e vlerave të një individi.

Qëndrimi ndaj përdorimit, mendohet se varet nga tre ndryshoret e përmendura si dobia e përceptuar, lehtësia e përdorimit dhe përputhshmëria. Qëndrimi ndaj përdorimit mund të bëhet më pozitiv nëse rriten lehtësia e përdorimit, dobia dhe përputhshmëria e një teknologjie të caktuar.

Përfundimisht, sipas Fred Davis, përdorimi i teknologjisë përcaktohet nga ndërthurja e faktorëve të përmendur, nga qëllimi se pse do të përdoret kjo teknologji dhe sa është pozitiv qëndrimi i përdoruesit ndaj teknologjisë së caktuar(Davis, 1989).

Në ditët e sotshme ka shumë studime të vlefshme për atë se si përdoret TIK nga ana e mësimdhënësëve dhe si do të duhej të përdorej, fatkeqësisht studimet në gjuhën shqipe janë shumë të pakta përderisa nevoja jonë për njohuri në këtë drejtim është shumë e madhe. Një studim i rëndësishëm mbi mënyrën se si e përdorin TIK-un mësimdhënësit e shkollave të mesme në Kanada nga grupi i mësimdhënësëve të dy Universiteteve në Kanada na jep informacione se si mësimdhënësit përfitojnë nga teknologjia(Nipissing University,2017). Shkollat, sipas studimit shfrytezojnë Google Docs për të zgjidhur problemin e ruajtjes së detyrave të nxënësëve, në mënyrë që të eliminohet mundësia e humbjes së tyre (nëse ruhen në njësi të lëvizshme memoruese). Dhe kjo sipas studimit ka sjell përmirësim të konsiderueshëm në organizimin e dosjeve të studentëve. Të gjithë mësimdhënësit kanë llogari në Gmail, që e lëhtëson shumë shpërndarjen e detyrave si dhe nëse nxënësit punojnë në grupe projekte p.sh në Power Point, të gjithë mund të kontribojnë në detyrë. Pasi të përfundojnë projektin ata ndajnë fajlin me mësimdhënësin për vlerësim dhe ai mund të identifikoj se kush ka punuar në projekt dhe kur. Kjo ndihmon shumë në vlerësim. Gjithashtu mësimdhënësit e shkollave të hulumtuara përdorin edhe platformat Live Binders, Desire2Learn, TalkingTom dhe Photobooth. Programe këto që i'u ndihmojnë gjithë nxënësëve duke i përfshirë edhe ata me nevoja të veçanta.

Teknologjia e Informimit dhe Komunikimit mund të këtë impakt te në performancën e nxënësëve vetëm nëse mësimdhënësit kanë njohuri të mjaftueshme për teknologjinë dhe integrimin e saj në kurikulën shkollore. Njohuritë e tilla ofrojnë mundësi krijuese, të individualizuara për nxënësit për të shprehur dijet e tyre dhe për të ndjekur trendet e zhvillimit teknologjik në shoqëri dhe në vendet e punës në të ardhmën(Unesco International Institute for Educational Planning, 2010).

Studimi tjetër i kësaj natyre, nga Sara Sharick (Universiteti Walden, 2016), hulumton mënyrat se si mësimdhënësit mund të plotësojnë nevojat e të nxënurit të nxënësëve. Ndryshimet pozitive përfshijnë nevojën që mësimdhënësit jo vetëm të kenë njohuri në përdorimin e teknologjisë por edhe të kuptojnë rëndësinë e zhvillimit profesional edhe për mënyrën e integrimit të teknologjisë në procesin mësimor. Mirëpo sipas gjetjeve të këtij studimi, mësimdhënësit nuk kanë zhvillimin profesional të duhur që në mënyrë efektive të integrojnë TIK-un në procesin e të mësuarit. Në shumicën e rasteve ata thjesht japin detyra duke përdor teknologjinë por pa e zhvilluar mendimin kritik dhe zgjidhjen e problemeve.

Gjithashtu kur bëhet fjalë për teknologjinë dhe integrimin e saj në procesin mësimor, rol shumë të rëndësishëm sidomos në këtë vit shkollor(2019-2020) për shkak të situatës së pandemisë, kanë edhe përdorimi i sistemeve për menaxhimin e mësimdhënies dhe përzgjedhja e duhur që përshtatet me kërkesat e nivelit të institucionit edukativ. Edhe në këtë drejtim në të kaluarën edhe sot vazhdojnë të zhvillohen platforma të shumta dhe nuk

mungojnë hulumtimet të cilat tregojnë se si duhet të përdoren dhe si po përdoren këto platforma.

Sistemi i menaxhimit të të mësuarit (LMS) është e specializuar si Teknologji e sistemeve Mësimore, bazuar në Internet dhe WWW për të siguruar edukimin dhe trajnimin me standardet e hapura të të mësuarit në distance(Blurton,2002). Hartimi dhe zbatimi i sistemeve të tilla nuk është detyrë e lehtë, pasi që kemi të bëjmë me teknologji komplekse që përfshijnë shumëllojshmëri të komponenteve organizative, administrative, mësimore dhe teknologjike. LMS ka një rëndësi të veçant dhe trajtohet si e tillë përmes studimeve të ndryshme. Duke filluar nga ajo e të kuptuarit se çka në të vërtetë është një LMS dhe cilat janë konceptet që shkaktojnë konfuzion. Shembull është artikulli "An Argument for Clarity: What are Learning Management Systems, What are They Not, and What Should They Become? I cili tërheq vëmendjen lidhur me atë se çka është në të vërtetë LMS dhe cilat janë ngjashmëritë dhe diferencat me konceptet tjera dhe rekomandimi për përdorimin e drejtë të termit në literature(Watson, 2012). Kjo bëhet duke dhënë definicione konkrete se çka është dhe çka nuk është LMS, duke dhënë një histori dhe duke krahasuar konceptet e ngjashme të cilat edhe mund të përfshihen brenda LMS por megjithatë kanë karakteristikat që i dallojnë. Kështu çelësi për të kuptuar diferencën në mes të LMS dhe termeve tjera të aplikacioneve të edukimit është të kuptohet natyra e sistemit të LMS, poashtu edhe natyra e koncepteve të ngjashme siç janë CMS (Course Management System), LCMS (Learning Content Management System) dhe LO (Learning Object). Për sqarimin e këtij konfuzioni potencial, për të parë saktësisht se ku janë ngjashmëritë dhe dallimet janë përdorur definicione nga autor të ndryshëm. Vetëm të kuptuarit e konceptit të LMS-së, nuk është i mjaftueshëm për realizimin e potencialit që ofron kjo teknologji në edukim. Studimi rreth implementimit dhe efektiviteti të LMS është shumë i rëndësishëm. Një aspekt tjetër shumë i rëndësishëm para se të blehet ose te merret një LMS open sourse, është zgjedhja adekuate. Zgjedhja e një LMS është një nga vendimet më të rëndësishme për çdo institucion. Edhe pse shumica e këtyre sistemeve përmbajnë elementet themelore të ngjashme, ato janë optimizuar për lloje të ndryshme të qëllimeve të mësimit, nxënësëve dhe organizatave. Në këtë aspekt dallimet janë të mëdha. Që një LMS të jetë i suksesshëm duhet patur shumë kujdes në përzgjedhje dhe përshtatshmëri me vendin ku do të përdoret. Një udhëzues për çështjet, mundësitë dhe proceset që duhet të merren parasysh gjatë zgjedhjes së një LMS sistemi vjen nga autorët Peter Berking, Shane Gallagher(Berking&Gallagher, 2011). Autorët janë të fokusuar në LMS por japin edhe konsiderata për fusha më të gjera pasi ato do të merren parasysh në zgjedhjen e sistemeve të menaxhimit dhe mësimdhënies për të treguar se në disa raste një nga sistemet e përmendura mund të jetë një zgjedhje më e mirë se sa një LMS. Në këtë kontekst janë bërë edhe studime duke i krahasuar dhe vlerësuar LMS-të e ndryshme, pra nëse përzgjedhja e një LMS-je afekton procesin e të mësuarit. Konkretisht për krahasim janë përzgjedhur Moodle, Fronter dhe CEWebS. Platformat në fjalë kanë përmbushur funksionalitete të mjaftueshme për kryerjen e detyrave rutinë pak a shumë në mënyrë efektive. Sipas këtij studimi implementimi i suksesshëm i skenarit të mësuarit të

përzier varet nga zgjedhja e përshtatshme e e-learningMachado dhe Tao studiuan eksperiencen e përdoruesve përmes karahasimit të Moodle dhe Blackboard(Brayant&Tao, 2011). Ata përdorën pyetsorët online për krahasim të eksperiencës së përdoruesve për funksionet bazike të secilit sistem si veglat e komunikimit, veglat për interaksionin student-student dhe interaksionin student-instruktor. Rezultatet e studimit treguan se në përgjithësi Moodle ishte më e preferuar si zgjidhje për përdoruesit. Qështje tjetër e studimit për LMS, është edhe roli i tij në të ardhmën. Studimi është bazuar kryesisht në shqyrtimin e metodave të mësimdhënies online, shqyrtim i LMS-ve të reja, intervista me shitësit dhe një analizë e njëzetepes rasteve të studimit të inovacionit të mësimdhënies dhe të mësuarit nga njëzetepes institucione të Ontarios, të plotësuar nga intervistat me stafin e Universitetit British Columbia në Vancouver.Rezultatet ishin në favor të përdorimit të LMS-ve edhe në të ardhmën dhe atë për tri arsye kryesore: mësimore, administrative dhe teknike. Shumica e mësimdhënësëve dhe studentëve mirëpresin një strukturë të organizimit të mësimdhënies dhe të mësuarit. Për shumicën e mësimdhënësve LMS-të sigurojnë fleksibilitet të mjaftueshëm për të përshtatur një varg të stileve të mësimdhënies si dhe zhvillimet e reja open sourse dhe cloud computing, po sigurojnë fleksibilitet edhe më të madh(Contact North, 2012).

5.Disponueshmëria e TIK-ut në ambientet shkollore

5.1 Gjendja e tanishme ne shkollate e Mesme të Lipjanit

Në përgjithësi gjendja në shkollat e mesme të Lipjanit ashtu si në gjithë Kosovën nuk është e kënaqshme dhe në shumë aspekte ka nevojë për ndërrime rrënjësore. Duke u nisur nga objektet ekzistuese të cilat janë me hapsira të pamjaftueshme për ta përballuar numrin e madh të nxënësëve që e frekuentojnë, poashtu edhe me kushtet e punës në të cilat punohet, të cilat janë larg kërkesave dhe nevojave të kohës.

Në gjimnazin „Ulpiana“ dhe Shkollën e Mesme Profesionale „Adem Gllavica“, klasat nuk janë të pajisura me infrastrukturën elementare për zhvillimin e mësimit. Kështu përveç desktop kompjuterëve që përdoren nga administrata e shkollës, nuk ka as kabinete të informatikës e as të lëndëve tjera. Stafi i profesorëve të TIK-ut, orët mësimore i zhvillojnë duke përdorur laptopët personal si dhe disa projektorë që i posedojnë shkollat. Kështu që nuk mund të flitet aspak se shkollat disponojnë me infrastrukturën e nevojshme për përdorimin e TIK në procesin mësimor. Megjithatë, në këto kushte mund të thuhet se përmes këtyre pajisjeve lehtësohet mjaft mirë prezentimi i përmbajtjeve mësimore duke përdorur aplikacionet për prezentim p.sh Power Point.

5.2 Propozim i dizajnit

Dizajni i infrastrukturës në një shkollë presupozon një plan të caktuar për shfrytëzimin e saj. Parimet mbi të cilat një sistem i tillë është i bazuar janë:

- Qasje univerzale dhe të barabartë për të gjithë
- Mjetet e duhura për rritjen e efikasitetit
- Shfrytëzimi optimal dhe kostoja minimale e operimit.

Kompjuterët

Duhet pasur kujdes të madh kur blehen paisjet, në mënyrë që të merren ato që paguhen. Do të ishte e mjaftueshme paisja me kompjuter me 3GHz shpejtësi, 500Gb Hard Disk (HDD) me 4GB RAM. Desktop kompjuterët janë më të përshtatshëm për shkak të çmimit më të lirë, sistemin më të fuqishëm dhe mundësia për vjedhje më e vogël.

- Për mësimdhënie efikase dhe për t'i kursyer paisjet e kërkuara, është e këshillueshme që të projektohet klasa për grupe të përgjysmuara(15-18 nxënës).
- Kompjuterët mund të instalohen përgjatë të dyja anëve, përball tabelës së shkrimit, ose në dy rreshta përball njëri tjetrit në mes të dhomës.
- Sigurohen vendkyçje të mjaftueshme elektrike dhe internet ashtu që rrjeti i telave instalohet në dysheme ose në kanale të posaçme të projektuar me qëllim të mirëmbajtjes si dhe instalohen kyçje për projektor në tavan;
- Shmanget shkëlqimi i fortë nga dritarja

Vendosja e kompjuterëve mund të bëhet në mënyra të ndryshme për të siguruar radhitjen e duhur të nxënësëve dhe të përshtatshme me llojin e të mësuarit, varësisht nga hapsira në dispozicion.

Pajisjet dhe orenditë

Nxënësit të cilët kalojnë kohë duke punuar në kompjuter të ulur në pozicion të gabuar, rrezikojnë shëndetin. Nuk ekziston ndonjë qëndrim ulur që është ideal për shfrytëzimin e tastierës. Idealja do të ishte që të sigurohen karrige, tavolina të kompjuterit të cilat rregullohen dhe përshtaten. Çdo tavolinë duhet të ketë një tavolinë kompjuteri të paisur me sirtar, pllakë dërrase për kompjuter dhe një raft të vogël rrëshqitës për tastierë.Tabela e shkrimit duhet të jetë e bardhë(me marker) për të evituar pluhurin e shkumsit. Tavolina e arsimtarit duhet të jetë e paisur me kompjuter me system kabllor të rrjetit, me modem, shtypës dhe të gjitha sistemet e nevojshme të rrjeteve elektrike, UPS-ave dhe prizave(Ministria e Arsimit dhe Shkences,[MASH],2012).

Ndriçimi

Rekomandohet vendosja e perdeve ose e roletneve nëpër dritare për të shmangur shkëlqimin nëpër ekran dhe për të mbrojtur paisjet. Secila tavolinë me kompjuter duhet të jetë e pajisur me ndriçim të vaçantë, që mund të lëvizet në tri drejtimet dhe që vendoset anash kompjuterit. Më së miri është që ekrani të vendoset në pjesën pingule ndaj dritares.

Kushtet teknike

Dhoma duhet të ketë furnizim elektrik, ngrohje dhe ventilim që funksionon edhe pas orarit të rregullt mësimor. Dy priza elektrike, një vendkyçje për internet, duhet të sigurohet për secilën tavolinë të kompjuterit. Kabllot duhet të jenë të mbrojtura me siguri maksimale. Duhet të mbahet temperature e rregullt dhe të bëhet ajrosje adekuate e dhomës, nëse është e mundur me kondicioner ajri ose me sistem ngrohës me pompim për të siguruar funksionim të duhur të kompjuterëve(MASH, 2012).

Kushtet e sigurisë

Dhoma e kompjuterëve dhe paisjet e shtrejta duhet të mbrohen nga vjedhja dhe vandalizmi. Pika e qasjes duhet të ketë vetëm një njësi dhe duhet të ketë dry të sigurisë së lartë. Dritaret duhet të jenë të projektuara për parandalimin e hyrjes së paautorizuar.

Menaxhimi i rrjetit

Një ndër sfidat e mundshme është menaxhimi i paisjeve në mënyrë që ato të përdoren në mënyrë efektive. Kjo d.m.th kontrollin e përdorimit të kompjuterëve si krijimi dhe menaxhimi i llogarive, instalimin e aplikacioneve, mbrojtjen e kompjuterëve nga viruset, monitorimin dhe menaxhimin e përdorimit të harduerit, menaxhimi i platformave për menaxhimin e të mësuarit në përdorim etj.

Mbështetja teknike

Rrjeti i sistemit të shkollës duhet të jetë i besueshëm për të inkurajuar besimin e përdoruesit dhe për të mbështetur të mësuarit dhe mësimdhënien, poashtu edhe administrimin dhe menaxhimin e shkollës. Kjo kërkon mbështetjen teknike që mund të ofrohet nga shërbimet e brendshme, stafi i TIK-ut, teknikët brenda shkollës, ose ofrues të jashtëm të këtyre shërbimeve.

6.Mënyrat për motivimin e mësimdhënësve që të përdorin TIK në procesin mësimor

Integrimi i teknologjisë institucione edukimi dhe të mësuarit digjital nuk është ndonjë proces me kërkesa shumë të mëdha, do të mjaftonte një kompjuter dhe projektor i vendosur në klasë dhe do të mund të themi ja ku e kemi teknologjinë. Por të mësuarit dixhital fillon me mësuesit, performanca e të cilëve zgjerohet me ndihmën e teknologjisë dhe jo në ndonjë mënyrë tjetër. Teknologjitë e reja në klasë janë menduar për të shtuar angazhimin e studentëve dhe për të lehtësuar punën e mësuesve. Por, mungesa e njohurive, mësimdhënësëve do të ju krijonte shqetësime dhe pasiguri në vend se ata të ndiheshin më të lehtësuar. Institucionet e edukimit shpesh i kushtojnë rëndësi të madhe pajisjes me teknologji ndërkohë që zhvillimi i mësimdhënësëve lihet shumë anash. Mësimdhënia e mirë, veçanarisht me përfshirjën e teknologjisë nganjëherë kërkon këshilla dhe mbështetje. Fillimishtë është e nevojshme një strategji gjithëpërfshirëse për implementimin e teknologjisë në sistemin e shkollës, në planifikimin e së cilës duhet të jenë të përfshirë edhe mësuesit. Drejtuesit dhe mësuesit e institucionit duhet të vendosin rreth përmirësimit të të mësuarit, teknologjisë që do të përdoret dhe si do të shfrytëzohet koha në mënyrë efikase. Mësuesit duhet të bëhen dizajnues të edukimit, ashtu si teknologjia zhvillohet ashtu edhe mësuesit duhet të zhvillohen profesionalisht , për të qenë në hap me kohën. Për shumë vite me radhë mësuesit kanë qenë në qendër, kanë qenë pika e vetme e qasjes me njohuritë. Por sot gjërat kanë ndryshuar shumë, mësuesve sot u duhet të zgjedhin dhe zhvillojnë llojet e përmbajtjes që do t'i qasen nxënësit. Megjithëse një pjesë e madhe e institucioneve janë të pajisura me teknologji bazë, prap se prap këto teknologji janë pak të përdorura nga ana e mësuesve. Arsyeja është se llojet e programeve të trajnimeve të ofruara në të kaluarën nuk prezentojnë gjenerim të metodave që janë të nevojshme aktualisht, pra ndryshim të sjelljeve dhe praktikave të përditshme, për të mirë si pasojë e përvojës së zhvillimit profesional. Në vend të kësaj mësimdhënësit duhet mësuar për përdorimin e teknologjive të reja në mënyrë që nxënësit e tyre të zotërojnë konceptet kyçe dhe aftësitë e kërkuara sipas standardeve të kurikulës.Teknologjia në komunikim nuk nënkupton Power Point-in, Excelin apo Wordin. Fokusi i zhvillimit profesional duhet të jetë në të mësuarit dhe strategjitë e të mësuarit që e bëjnë diferencën në praktikat ditore, në aktivitetet të cilat sjellin performancë më të mirë të studentëve. Si rezultat i këtyre praktikave dhe përdorimit të veglave të reja nxënësit duhet të jenë të aftë të lexojnë, arsyetojnë, shkruajn më fuqishëm, të kenë komunikim më produktiv me antarët e komunitetit global, hulumtojnë dhe reflektojnë për pyetje të rëndësishme, zgjedhje dhe qështje të rëndësishme të kohës së tyre dhe të performojnë më mirë në kërkesat e reja të testeve shtetërore.

6.1 Nevojat e mësimdhënësëve

Përdorimi i teknologjisë në të mësuar mund të rezultojë në performancë të shkëlqyer të studentëve. Rrjetet shpesh sjellin informacion të shumtë në forma, pjesë dhe kultura të ndryshme si dhe në rastin më të keq informacioni mund të jetë i deformuar. Pa një fokus në principet e edukimit, të mësuarit me këtë teknologji mund të shkaktojnë shprehinë e kopjimit të informacionit i cili zvogëlon aftësinë e studentëve për të menduar. Prandaj institucioni duhet të ketë të qartë programin arsimor për përfshirjen e rrjetit kompjuterik në shkolla. Pra , të mësuarit është qëllimi kurse teknologjitë janë sisteme që e bëjnë më të lehtë. Sfida e vërtetë e zhvillimit profesional është inspirimi dhe përgaditja e mësimdhënësëve në fillimin e këtyre aktiviteteve me veglat e nevojshme. Trajnimi i ofruar ECDL, me shtatë modulet përbërëse, nuk mundet në asnjë mënyrë që të trasformojë mësuesit tradicional në mësues konstruktiv. Transferimi i stilit të të mësuarit, preferencave dhe të sjelljeve kërkojnë bindje, mësim nga eksperienca dhe rrugë individuale të të mësuarit. Sidomos, gjatë kësaj periudhe pandemie, meqë përdorimi i teknologjisë nuk kishte alternativë, nevoja e mësimdhënësësëve për njohuri se si të përdoren dhe si të ndërlidhet teknologjia në mësimdhënie ishte shumë e madhe dhe përkrahja në këtë drejtim ishte shumë e vogël.

6.2 Ku janë gabimet

Shkollat janë mbështetur shumë kohë në modelet e trajnimit të cilat kanë vënë theksin në të mësuarit e softuerit. Modeli i trajnimit zakonisht është vetëm një hap i serisë së aftësive të mësimit me pak përshtatje të bëra për stilet individuale të të mësuarit të studentëve, fazave të zhvillimit apo preferencave personale. Sepse aftësitë shpesh mësohen jashtë kontekstit, ato duken të largëta nga praktikat e klasës dhe i bëjnë disa mësues të mendojnë për dobitë dhe vlerën e këtyre aftësive. Përdorimi i shembujve të përgjithësuar të trajnimeve e rritë edhe më shumë hendekun për mësimdhënësit ose edhe më keq , shumë kompani të trajnimit të softuerëve mbështeten në shembujt e biznesit dhe nuk japin informacione per edukim. Modelet e trajnimeve nganjëherë i bëjnë mësimdhënësit të ndihen keq pasi nxiten të mësojnë shumë aftësi për një kohë shumë të shkurtër, si dhe me udhëzime dhe praktika të pamjaftueshme. Si pasojë edhe njohuritë e marra janë të pamjaftueshme dhe jo të aplikueshme dhe nxisin deklarimin e mësimdhënësëve se nuk janë të përgaditur për përdorimin e teknologjisë.

6.3 Kultivimi i zhvillimit profesional

Shumica e strategjive efektive të të mësuarit kërkojnë ndryshime në mënyrën se si mësuesit e kalojnë kohën dhe punojnë në klasë. Mbështetja e sistemeve informale, partneritetet dhe strukturat bashkëpunuese mund të jenë elementet më efektive dhe bazë e gjerë për ndryshime. Në shumë institucione, mësuesit janë të izoluar nga njëri tjetri duke u marr me oraret e tyre. Shumë mësues kapen pas rutinave të kaluara derisa të pajisen dhe inkurajohen për të gjetur rutinat e reja që janë të besueshme dhe të përshtatshme për zëvendësimin e atyre paraprake. Ky kërkim për kreativitet kërkon ndryshime në shkolla të cilat do të nderpresin izolimin, lehtësojnë punën në ekip dhe ofrojnë kohë të mjaftueshme për programe të zhvillimit.

6.3.1 Strategjitë efektive

Ndryshimi i vërtetë në kulturën e të mësuarit të një institucioni edukimi kërkon përpjekje gjithëpërfshirëse. Përpjekjet individuale mund të japin kontribute të rëndësishme, por mbështetja më e madhe arrihet përmes bërjës bashkë të disa strategjive të cilat krijojnë impaktin në kulturën e të mësuarit, si:

- **Programet e rritjes profesionale**. Nën këtë skenar, ministria e arsimit me mbështetjen e mësimdhënësëve, miraton programin e rritjes profesionale ku sqarohet angazhimi i stafit në ndryshimin dhe zhvillimin e vazhdueshëm profesional.

  Komponent kyç është plani i rritjes profesionale i shkruar nga çdo mësimdhënës duke i ndjekur udhëzimet e dala nga drejtoria apo ministria e arsimit. Dhe ky plan do të duhej të fillonte me vendosjen e objektivave: çka u duhet nxënësve të dinë dhe çka do të jenë në gjendje të bëjnë? Pastaj bëhet zgjedhja e teknologjive që mbështesin këto objektiva, si do të përdoren këto teknologji dhe vlerësohet efikasiteti i tyre. Ky dokument, bëhet hartë rrugore që drejton mësimdhënësit në mësimdhënie gjatë tërë vitit si dhe ndihmon drejtorët të jenë mbikqyrës efektiv duke ju siguruar resurse dhe mbështetje të nevojshme.

  Zakonisht, mësuesit listojnë dy ose tri fusha kryesore për rritje dhe specifikojnë aktivitetet e mundshme për nxitjen e rritjes. Dhe në rast se janë bërë investimet e nevojshme me teknologji të re, të gjithë mësimdhënësëve do tu kërkohej të përfshijnë si qëllimin integrimin e teknologjisë.

- **Grupet e studimit.** Mësuesit mblidhen në grupe të vogla, takohen çdo javë për një kohë të caktuar dhe ndajnë qëllimet e përbashkëta të rritjes, të listuara më parë në planet e rritjes profesionale të tyre. Kështu, përcaktohet rruga më e mirë drejt

plotësimit të qëllimeve. Ata mund të regjistrohen në klasa, kërkojnë tutoriale të vogla, shfletojnë burime online, lexojnë libra profesional dhe marrin pjesë në konferenca së bashku. Në përgjithësi mësimdhënësit mësojnë më mirë kur mund të bëjnë zgjedhje në përmbajtje dhe stile përderisa e kanë mbështetjen e pjesës tjetër të mësimdhënësëve në ekip, parim ky i mësimit për të rritur.

- **Zhvillimi i kurikulave/ekipi krijues.** Kur mësimdhënësit mblidhen për ndërtimin e njësive të bazuara në standarde, të cilat do t'i përdornin me nxënësit e tyre, ndodh edhe vendosja e teknologjive të reja. Përzierja skeptike e mësimdhënsëve të adoptuar vonë në të njejtin ekip me mësimdhënësit entuziast që janë adaptuar më heret si dhe libraritë e forta të shkollave mund të konvergjojnë në respekt reciprok ku krijuesit eventual gjejnë gjuhën e përbashkët gjatë procesit të kërkimit të rrugëve të reja për zhvillim dhe rritje.

Edhe pse në qendër të këtyre aktiviteteve mund të jetë kurikula dhe të mësuarit e studentëve, mësimdhënësit e përfshirë në proces njëkohësisht fitojnë njohuri dhe nxiten për të menduar për natyrën e aktivitetit, 'learning by doing' që është një tjetër parim i mësimnxënjës së të rriturve. Pjesmarrësit që kanë aftësi të kufizuara në teknologji shpesh dalin me më shumë komoditet, shkathtësi dhe kompetenca dhe dëshirë për të përdorur veglat e reja.

- **Trajnerët e teknologjisë, mentorët dhe kuadrot.** Institucionet edukative kanë gjetur se mësimdhënësit mund të bëjnë progres të mjaftueshëm në mësimin e teknologjive të reja nëse ata kanë partner të aftë që punojnë së bashku me ta. Mësimdhënësëve më efektiv ju jepet roli i mentorit për një kohë të caktuar, në mënyrë që mësimdhënësit të vonuar në adaptim të mbështeten në fazat e vështira. Involvimi i mentorëve është i përkohshëm derisa mësimdhënësit të adoptohen, zhvillojnë aftësi dhe besim.

Në një strategji të tillë, shkollat krijojnë kuadro drejtuese me një përzierje të mësimdhënësëve që i eksplorojnë avantazhet kryesore të praktikave të reja dhe ndihmojnë pjesën tjetër të mësimdhënësëve në përqëndrimin e mësimit te mundësitë që ja vlen të ndjeken. Në këtë mënyrë, kuadri bëhet faktor kryesor në planifikimin e mundësive në zhvillimin professional për pjesën tjetër të stafit(Lei&Wan&Ka Lok Man,2013).

- **Vizitat e institucioneve, konferencave.** Ndryshimi i vërtetë mund të ndodh kur mësimdhënësit kanë mundësi për të parë botën jashtë institucionit. Duke

qenë të izoluar nga zhvillimet e reja brenda objektit shkollor, mësimdhënësit nuk kanë mundësi të vlerësojnë praktikat e reja që ndodhin rreth tyre. Vizitat e tilla si në institucionet e tjera të edukimit me zhvillim më të madh apo kompani që tregojnë si teknologjia përdoret në mjedise tjera mund të ketë vlerë të madhe dhe merret në konsideratë në implikimin në programin mësimor të institucionit.

- **Të mësuarit online.** Është një mundësi e madhe që duhet të shfrytëzohet nga mësimdhënësit për rritjen e zhvillimit profesional në përgjithësi dhe shtimin e aftësive për përdorimin e teknologjive në veçanti. Me anë të mësuarit online mësuesit mund të aftësohen dhe rrisin përvojat pa pasur nevojë të ndjekin klasat formale. Ofertat e tilla janë të shumta, duke u nisur nga ato që ofrojnë leximin në internet, detyra dhe chat seanca, mësime tërheqëse, supstanciale dhe gjenerative. Këto programe të të mësuarit online mund të ofrojnë shumë avantazhe: theks në të mësuarit përkundrejt mësimdhënies, të mësuarit që është i pavarur nga koha apo vendi dhe mësim që përshtatet dhe bazohet në kompetenca.

7.Analiza e impaktit të ekspozimit të nxënësve në TIK

7.1Analiza e testit të nxënësëve të ekspozuar dhe joekspozuar në TIK

Se sa ka ndikim ekspozimi apo mbajtja e orëve mësimore me metodologji të bazuara në përdorimin e TIK-ut krahasuar me orët mësimore të bazuara në metodat tradicionale pa integrimin e TIK-ut brenda saj, për të marrë të dhënat e kërkuara që janë pjesë e këtijë studimi konkretisht për të vërtetuar apo jo hipotezën se *Ekspozimi i nxënësëve në TIK ka shumë efekt pozitiv në procesin e mësimnxënies krahasuar me nxënësit e po të njëjtit vit që nuk janë të ekpozuar në te*, kemi bërë testimin e nxënësëve të klasës së XI-të, paralelja 1 . Në periudhën e parë mësimore klasat janë ndarë në dy grupe dhe grupet një javë kanë ndjekur mësimin në klasë dhe javën tjetër kanë ndjekur mësimin online. Kështu për nxënësit e dy grupeve njësia mësimore e njejtë (Të dhënat në internet, Libri TIK 11, faqe 41) është mbajtur në dy mënyra të ndryshme. Me grupin e parë njësia mësimore është mbajtur me ndihmën e TIK-ut, konkretisht përmes projektorit nxënësit kishin mundësi të shohin videoanimacionin (https://www.youtube.com/watch?v= hDHJxndSups&ab_channel=Wisc-Online) përmes të cilit shumë qartë dhe thjesht përmes shembujve nga përditshmëria spjegohet se si të dhënat udhëtojnë në internet si dhe shkarkimi/ngarkimi i të dhënave u demostrua me shembuj konkret. Grupit të dytë, e njejta njësi mësimore i'u ofrua me metoda tradicionale. Fillimisht u dhane konceptet kyçe e pastaj nxënësëve i'u dha për detyrë leximi i njësisë mësimore në libër si dhe më pas diskutim rreth asaj që kishin kuptuar ose jo. Në orën e ardhëshme secili grup përkatësisht u testua me të njejtat pyetje.

Grupi i parë(15 nxënës, që ishin ekspozuar në TIK) treguan këto rezultate: 6 nxënës u përgjigjën saktësisht në të gjitha pyetjet, 2 nxënës morrën 8 pikë, 3 nxënës morrën 7 pikë nga 10 gjithsej, 3 nxënës morrën 4 nga 10 pikët e mundëshme dhe një nxënës morri vetëm 1 pikë.

Grupi i dytë (15 nxënës, që nuk ishin të ekspozuar në TIK) treguan këto rezultate: 2 nxënës morrën pikët maksimale, 4 nxënës morrën 6 pikë nga nga 10, 5 morrën 4 nga 10 dhe pjesa tjetër 4 nxënës kishin vetëm nga dy përgjigje të sakta(2 pikë nga 10).

	10 pikë	**9 pikë**	**8 pikë**	**7 pikë**	**6 pikë**	**5 pikë**	**4 pikë**	**3 pikë**	**2 pikë**	**1 pikë**
Grupi 1	6	0	2	3	0	0	3	0	0	1
Grupi 2	2	0	0	0	4	0	5	0	4	0

Tabela 1. Krahasimi i rezultateve te nxenenseve te testuar

7.2 Analiza e pyetësorit të nxënësëve

Në hulumtim janë përfshirë dyqind nxënës të shkollave të mesme të larta të komunës së Lipjanit(Gjimnazi “Ulpiana”, SHMP “Adem Gllavica”, SHMP “Shaqir Hoxha”), prej tyre pjesa më e madhe nxënës të klasave të dymbëdhjeta dhe pjesa tjetër të klasave njëmbëdhjeta dhe klasave dhjeta. Pyetsori është shpërndarë në formë elektronike përmes platformave të ndryshme por kryesisht përmes platformës Google Classroom, pasiqë tashmë veç dihet që nxënësit janë të obliguar që të jenë pjesë e këtyre platformave.



Figura 1. Klasat që vijojnë nxënësit

Prej numrit të përgjithshëm të nxënësëve të cilët vullnetarisht i’u përgjigjen pyetësorit, pjesa më e madhe e tyre(79.60%) janë femra kurse një pjesë e vogël e tyre(20.4%) meshkuj.



Figura 2. Gjinia e nxënësëve

Në ditët e sotme përdorimi i internetit është jashtzakonisht i përhapur nga të gjitha kategoritë dhe grupmoshat e ndryshme. Këtu bëjnë pjesë padyshim edhe nxënësit e shkollave të mesme. Por pse përdorët interneti kryesisht, jemi munduar të gjejmë përgjigje përmes pyetjes së mëposhtme.



Figura 3. Pse e përdorin internetin nxënësit

Shumica e nxënësëve janë përgjigjur se internetin e përdorin për kërkim të informacioneve(89.10%) dhe për komunikim(73.80) si dhe një pjesë më e vogël e tyre për argëtim(46%).



Figura 4.Ku e përdorin internetin nxënësit

Sipas të dhënave të treguara në grafikun e sipërm, nxënësit internetin mund ta përdorin pothuajse vetëm në shtëpi(95.52%) dhe shumë pak në shkollë(4.47%).



Figura 5.Sa kohë e përdorin internetin gjatë javës

Se sa kohë kalojnë nxënësit në aplikacione të ndryshme online sipas diagramit të mësipërm shihet se nxënësit,68.80% prej tyre, e përdorin çdo ditë, 10.10% e përdorin dy ditë në javë ose më pak, tre deri në katër ditë në javë e përdorin 18.6% kurse vetëm 5 prej tyre apo 2.5% thonë që nuk e përdorin asnjëherë.



Figura 6.Si ndihen për përdorimin e TIK në klasë

Se si ndihen nxënësit gjatë përdorimit të tëknologjisë në klasë, në tabelën e mëposhtme kemi vendosur të dhënat të cilat tregojnë se nxënësit pajtohen se teknologjia i'u ndihmon që të jenë nxënës më të mirë dhë përmirëson aftësitë gjuhësore si dhe nuk nuk e evitojnë përdorimin e teknologjisë kur munden.



Figura 7. Sa e përdorin mësimdhënësit kompjuterin në klasë

Sa e përdorin mësimdhënësit kompjuterin dhe internetin në klasë, nga diagrami shifet se gjithë kohës shprehen ëvetëm 4% e nxënësëve, ndërsa aspak është një numër më i madh i nxënësëve, gjithësej 17.90%.



Figura 8. A mund të përdorin telefonat e mençur në klasë

Në lidhje me përdorimin e telefonëve dhe tabletëve në klasë nxënësit shprehen se nuk i'u lejohet, 94% e tyre kurse mund t'i përdorin këto paisje vetëm 6%.



Figura 9. A i bënë TIK-u mësimet më të kuptueshme?

Në rastet kur përdoret teknologjia në klasë, përmbajtjet mësimore a janë më të kuptueshme a jo, 56% e nxënësëve mendojnë që përmbajtjet janë shumë më të kuptueshme ndërsa vetëm 1% e tyre mendojnë që nuk janë aspak më të kuptueshme.

Megjithëse teknologjia jo gjithë kohës përdoret në klasë, por ajo përdoret nga nxënësit në shtëpi gati çdo ditë, ndaj dhe është me rëndësi të dihet se a i'u përmirëson rezultatet mësimore. Në këtë pyetje 78.30% prej tyre mendojnë se përdorimi i TIK ka ndikuar në përmirësimin e performancës së tyre.



Figura 10. Ndikimi në rezultate të nxënësëve

Përdorimi i TIK-ut në klasë lidhet ngusht me njohuritë e mësimdhënësëve në përdorimin e tij. Nxënësit mendojnë që mësimdhënësit e tyre kanë njohuri të mjaftueshme(29.6%) por ata nuk mendojnë që kanë shumë njohuri(49%).



Figura11. Sa e përdorin drejt mësimdhënësit TIK-un

Kur përmbajtjet mësimore shoqërohen me fotografi/video/grafikë , a është më i lehtë përshkrimi i tyre me gojë se sa sqarimet e shkruara? Gati gjysma e nxënësëve mendojnë që janë më efektive(48.5%), kurse aspak më efektive vetëm 1.5%.



Figura 12. Shpjegimet e matrelialeve multimediale a janë më efektive



Figura 13. Interaktiviteti gjatë përdorimit të TIK-ut

Zakonisht në shumicen e rasteve kur teknologjia përdoret në klasë kjo bëhet me prezentimin e përmbjtjeve mësimore kryesisht përmes Power Point-it. Gjatë kësaj kohe a mendojnë nxënësit se pengohet interaksioni me nxënës, 40.9% mendojnë se nuk e pengojnë shumë dhe aspak 33.7%.



Figura 14. Motivimi për kryerjen e detyrave

TIK-u rrit motivimin në kryerjen e detyrave të shtëpisë, mendojnë 69.2% e nxënësëve dhe nuk motivohen nga përdorimi i TIK-ut në kryerjen e detyrave ose aspak mendojnë 4.5% e nxënësëve.



Figura 15. Lehtësia e përdorimit të platformave të mësimit online

Nxënësit tanë prej vitit të kaluar për shkak të pandemisë kanë qenë të detyruar të ndjekin mësimin online përmes platformave të ndryshme dhe vijojnë të jenë pjesë e këtyre platformave. Përdorimi i këtyre platformave ka filluar në shumicën e rasteve pa udhëzimet e nevojshme. Sa e kanë të lehtë nxënësit përdorimin e këtyre platformave, 45.20% mendojnë se është shumë e lehtë kurse 8.5% e mendojnë që nuk është aspak e lehtë.

7.3 Analiza e pyetësorit të mësimdhënësëve

Në hulumtim janë përfshirë tridhjetë mësimdhënës të shkollave të mesme të larta të komunës së Lipjanit(Gjimnazi "Ulpiana", SHMP "Adem Gllavica", SHMP "Shaqir Hoxha"). Mësimdhënësit i takojnë të gjitha fushave kurrikulare të përfshira në planprogramet e shkollave të mesme. Mësimdhënësit japin mësim në klasat e dhjeta (46.47%), klasave të njëmbëdhjeta (23.30%) dhe klasave të dymbëdhjeta(30%).



Figura 16 Në cilat klasa japin mësim mësimdhënësit

Shumica e mësimdhënësëve që i'u janë përgjigjur pyetsorit(58.10%) kanë 5-10 vite përvojë pune, pjesa tjetër kanë 10 deri 20 vite përvojë pune(25.80%) apo mbi 20 vite përvojë pune(16.10%).



Figura 17. Sa kanë përvojë pune

Kompjuterin dhe internetin në klasë e përdorin gjithë kohës vetëm 9.4% e tyre, shpesh 40.6% prej tyre, ndërsa aspak 12.5%.



Figura 18. Sa e përdorin kompjuterin në klasë mësimdhënësit

Kompjuterin për përgaditjen e e orëve mësimore e përdorin pothuajse të gjithë apo 99%, por në klasë e përdorin 63%.



Figura 19.Kur e përdorin teknologjinë mësimdhënësit

Se sa ka paisje për përdorim në klasë nga ana e nxënësëve dhe mësimdhënësëve gjatë gjithë kohës, vetëm 3.3% kanë këtë mundësi sipas përgjigjes së mësimdhënësëve. Ndërsa që nxënësit nuk kanë kompjuter asnjëherë për përdorim në klasë mendojnë 51% e mësimdhënësëve.



Figura 20. Si e disponojnë TIK-un

Ndërsa për lejimin e përdorimit të paisjeve elektronike si laptop, tablet apo smartphone, nga diagrami shihet që nxënësëve tanë në shkolla nuk i'u lejohet përdorimi i smarphonëve kurse tabletët dhe laptopët mund t'i përdorin në klasë.



Figura 21. A i lejojnë nxënësit të përdorin smarphonët në klasë

Pjesmarrja në trajnime e mësimdhënësëve me shumë raste është e nevojshme pasi që kështu ata do të mund të zhvillohen profesionalisht si dhe të grumbullojnë pikët e nevojshme për licensim apo rilicensim. Kështu si të detyrueshëm pjesmarrjen në trajnime e shohin 53.10% e mësimdhënësëve ndërsa pjesa tjetër(46.9%) nuk e shohin si obligative.



Figura 22. Trajnimet e i kanë të detyrueshme mësimdhënësit

Se si përdoret interneti nga ana e mësimdhënësëve, kemi marrë përgjigjet e e mëposhtme. 41% e mësimdhënësëve hulumtojnë në internet gjithë kohës për përgaditjen e nësive mësimore, ndërsa rrall 3.3% e tyre. Shpesh përdorin aplikacione për përgaditjen e materialeve mësimore 48.38% e tyre, rrall 6.45. Krijojnë materialet e veta digjitale shumica prej tyre (gjithë kohës 22.58, shpesh 41.93%) dhe asnjëherë nuk krijojnë materiale digjitale 3%. Gjithashtu, shumica e mësimdhënësëve përgadisin ushtrime dhe detyra si dhe vlerësojnë dhe kthejnë informata kthyese online pasiqë tashmë veç janë të obliguar ta bëjnë këtë në klasat online nëse nuk e kanë aplikuar edhe më parë.



Figura 23. Aktivitetet në internet

Përdorimi i TIK-ut në klasë kushtëzohet nga shumë faktorë, disa prej këtyre faktorëve janë radhitur më poshtë dhe kemi kërkuar që mësimdhënësit të shprehen rreth ndikimit që kanë në përditshmërinë e tyre gjatë procesit të mësimdhënies/mësimnxënies. Shumica e mësimdhënësëve si faktor kryesor apo pengesë e përdorimit të TIK në klasë e mendojnë mungesën e paisjeve kompjuterike. Pamjaftueshmëria e dijeve adekuate nuk konsiderohet si faktor pengues, pak ose pjesërisht mendojnë 24 mësimdhënës. Materialet joadekuate dhe vështirësitë në integrimin e TIK-ut poashtu nuk shihen si faktor ndërkohë që edhe interesimi i pamjaftueshëm pjesërisht mendohet se ndikon në përdorimin e TIK në klasë.



Figura 24. Faktorët që ndikojnë në përdorimin e TIK në klasë

Aftësitë teknike apo në përdorimin e TIK nga ana e mësimdhënësëve janë shumë të rëndësishme. Se a ndjehen të sigurtë mësimdhënësit gjatë punës me TIK, kemi gjetjet si më poshtë. Shumica prej tyre dinë të përdorin procesorët e tekstit, excelin dhe powerpointin. Përdorimin e emaileve për komunikim e bëjnë nganjëherë 80% e tyre, si dhe në shkarkimin e aplikacioneve dhe përdorimin e platformave online janë të sigurtë shumica prej tyre.



Figura 25.Sa ndjejnë siguri në përdorimin e TIK

Përdorimi i TIK-ut në klasë sipas të dhënave të gjetura është shumë motivues pasi që shumica e tyre shprehen të motivuar 71.90% ndërsa pak të motivuar kemi vetëm 3% dhe asnjë prej mësimdhënësëve nuk ndjehet aspak i motivuar.



Figura 26. A motivohen nga teknologjia

Përdorimi i platformave online po bëhet thuajse në të gjitha shkollat, kështu kanë menduar edhe 71.9% e mësimdhënësëve, nuk e dinë se a përdoret a jo janë 3.10% dhe nuk i përdorin 25% prej tyre.



Figura 27. A i përdorin platformat për mësim online

8.Diskutimi i rezultateve

Meqë njëra nga hipotezat e këtij punimi kërkonte krahasim të grupeve të ekspozuara dhe jo të ekspozuara në TIK. Testimi është bërë me nxënësit e të njejtës klasë por të ndarë në grupe. Secilit grup i'u ofrua e njejta njësi mësimore por në njërin grup u përdor teknologjia(Videoanimacion, demostrim praktik) dhe grupit tjetër me metoda tradicionale spjegim, angazhim i nxënësëve(njësia mësimore e ndarë në pjesë i'u dha për lexim nxënësëve) si dhe diskutim në pjesën e fundit mësimore.

Nga praktikat tona personale gjatë punës së përditshme në mësimdhënie, kemi vrejtur se kur njësitë mësimore ofrohen me prezentime të cilat përfshijnë fotografi, grafika apo video, me demostrime praktike edhe pse nxënësit nuk kanë shumë mundësi të përfshihen në ushtrime praktike prap se prap nxënësit janë në gjendje të kuptojnë dhe mbajnë mend apo kthejnë detyra shumë më të sakta se sa vetëm kur spjegohet materiali mësimor pa përdorimin e TIK-ut. Kjo edhe vërtetohet nga rezultatet e testeve me dy grupet e nxënësëve. Nxënësit e grupit të ekspozuar në TIK grumbulluan pikë më shumë se sa ata që nuk u ekspozuan.

40% e nxënësëve të grupit të parë morrën pikët maksimale(10 pikë), kurse prej grupit të dytë vetëm 13.33% morrën pikët maksimale. Dy nxënës nga grupi i parë morrën 8 pikë nga 10, në grupin e dytë nuk kishte nxënës me 9,8,7 pikë. Në total nga 150 pikët e mundëshme që mund t'i grumbullonin grupet, grupi i parë grumbulloi 110 pikë(73.33%), ndërsa grupi i dytë 68(45.33%).

Në hulumtim janë përfshirë dyqind nxënës të shkollave të mesme të larta të komunës së Lipjanit(Gjimnazi "Ulpiana", SHMP "Adem Gllavica", SHMP "Shaqir Hoxha"), prej tyre pjesa më e madhe nxënës të klasave të dymbëdhjeta dhe pjesa tjetër të klasave njëmbëdhjeta dhe klasave dhjeta. Pjesa më e madhe e nxënësëve pjesmarrës në hulumtim janë femra(79.6%) dhe meshkuj vetëm 20.4%.

Sipas shumë të dhënave zyrtare në vend, Kosova është e mbuluar në pjesën më të madhe të saj me shërbime të internetit, dhe këto shërbime shfrytëzohen nga kategori dhe mosha të ndryshme gjatë gjithë kohës. Meqë në qendër të hulumtimit të këtij punimi janë nxënësit e shkollave të mesme dhe impakti që ka në performancën e tyre, pyetjet e parashtruara kanë qëllim të sjellin informacione të kësaj natyre.

Sipas nxënësëve pjesmarrës në këtë hulumtim, shumica prej tyre internetin e përdorin për kërkim të informacioneve dhe për komunikim dhe gati gjysma e tyre edhe për argëtim. Mirëpo në mungesë të infrastrukturës së nevojshme dhe paisjeve teknologjike, po ashtu edhe për shkak të politikave arsimore të cilat nuk lejojnë përdorimin e smarphonëve në klasë, nxënësit internetin e shfrytëzojnë në shtëpi dhe vetëm 4.47% e tyre shprehen që internetin mund ta përdorin edhe në klasë. Koha që nxënësit kalojnë në internet është

jashtzakonisht e madhe. Ata e përdorin internetin çdo ditë(68,8), shumica prej tyre dhe vetëm një pjesë e vogël e përdorin 2 ditë ose më pak. Rezultatet e gjetura në këtë pyetje janë tregues i qartë se tashmë nuk mund të flasim se a duhet të ekspozohen nxënësit TIK-ut a jo, mirëpo nuk duhet të rreshtur për të gjetur mënyra për të integruar sa më mirë dhe përshtatur me kurrikulën shkollore.

Nxënësit gjithashtu pajtohen se TIK-u ju ndihmon atyre në përmirësimin e aftësive gjuhësore dhe performancës në përgjithësi. Ata nuk e evitojnë përdorimin e tij dhe një pjesë mjaft e madhe e tyre mendojnë se do të ishin nxënës më të mirë po të mësonin përdorimin e drejt të tij.

Edhe pse gjithë kohën flitet për dixhitalizimin e shkollave, dihet që në shumë shkolla tona mungojnë pajisjet e domosdoshme për integrimin e TIK-ut. Megjithatë mësimdhënësit zakonisht përdorin laptopët personal, këtë e vërtetojnë edhe përgjigjet e nxënësëve sepse shumica e tyre mendojnë që mësimdhënësit e përdorin kompjuterin nganjëherë ose rrallë.

Gjithashtu në rastet kur përdoret teknologjia në klasë, me anë të prezentimeve, videove apo grafikave të ndryshme varësisht nga specifikat e lëndëve, shumica e nxënësëve mendojnë që përmbajtjet mësimore janë më të kuptueshme dhe ndjejnë që ndikon në përmirësimin e rezultateteve mësimore dhe kjo edhe prej faktit që ata mendojnë që mësimdhënësit e tyre kanë njohuri të mjaftueshme në përdorimin e TIK, duke mos e lënë anash edhe interaksionin me nxënësit e tyre gjatë kohës që përmbajtjet mësimore i prezentojnë përmes Power Poin-it.

Nxënësit tashmë janë pjesë e platformave të ndryshme për mësim online dhe mendojnë se është shumë i lehtë përdorimi i tyre dhe se ndjehen më të motivuar në kryerjen dhe dorëzimin e detyrave përmes këtyre platformave.

Detyrat e mësimdhënësëve janë jashtëzakonisht të rëndësishme. Ata kanë për detyrë të përgaditsin nxënësit të jenë konkurentë në jetën reale dhe kjo më shumë se kurrë është e ndërlidhur me përdorimin e teknologjisë në çfarëdo fushe jetësore.

Ndaj dhe pjesë e rëndësishme e hulumtimit në këtë punim është edhe këndvështrimi i mësimdhënësëve pasi që ata janë të lidhur drejtpërdrejt me procesin e mësimdhënëies/nxënies si dhe performanca e nxënësve varet shumë nga qasja që ata kanë ndaj teknologjisë dhe sa janë në gjendje ta përfshijnë në mënyrë të drejtë në planprogramet e tyre mësimore.

Në hulumtim janë përfshirë tridhjetë mësimdhënës të shkollave të mesme të larta të komunës së Lipjanit(Gjimnazi “Ulpiana”, SHMP “Adem Gllavica”, SHMP “Shaqir Hoxha”). Mësimdhënësit i takojnë të gjitha fushave kurrikulare të përfshira në planprogramet e shkollave të mesme. Mësimdhënësit japin mësim në klasat e dhjeta (46.47%), klasave të njëmbëdhjeta (23.30%) dhe klasave të dymbëdhjeta(30%).

Meqë teknologjia më së shumti përdoret nga grupmoshat më të reja, në pyetsorim që e kemi shpërndarë në mënyrë elektronike te kolegët tanë më së shumti janë përgjigjur mësimdhënësit që përvojën e punës e kanë 5 deri 10 vite (58.10%), 10-20 vite (25%) dhe ata që kanë mbi 20 vite përvojë pune i kemi deri 16%. Megjithëse shumica prej tyre(99%) e përdorin kompjuterin për përgaditjen e mësimeve, vetëm 63% prej tyre e përdorin gjatë mësimdhënies në klasë, mirëpo në këto raste vetëm mësimdhënësit janë ata që përdorin kompjuterin dhe internetin për arsye se nuk ka kompjuter të mjaftueshëm si dhe në shkolla është i ndaluar përdorimi i smartphonëve.

Që mësimdhënësit të mund të ndjekin trendin e zhvillimeve teknologjike, ata janë të detyruar(53.10%) të zhvillohen dhe avancohen profesionalisht vazhdimisht. Një pjesë e këtij zhvillimi profesional bëhet përmes trajnimeve që ofrojnë shkollat mirëpo në shumicën e rasteve trajnimet e ofruara nuk përmbushin mjaftueshëm nevojat e mësimdhënësëve për shkathtësitë e nevojshme në përdorimin e platformave të reja dhe teknologjive të domosdoshme për përdorim në klasë. Kështu, për shkak të situatës së pandemisë, shumica e mësimdhënësëve u përballën drejtpërdrejt dhe pothuajse pa asnjë ndihmë me sfidat e përdorimit të platformave online. Ata u detyruan që të gjejnë mënyra për të mësuar vet përdorimin e këtyre platformave dhe për këtë kishte probleme të shumta dhe përdorim jo të drejtë e me shumë gabime si në komunikimin sinkron ashtu edhe në atë asinkon (shpërndarjen e materialeve detyrave, dhe rezultateve me informata kthyese).

Mësimdhënësit gjatë punës së përditshme, shumë aktivitete i kanë të lidhura me përdorimin e teknologjisë. Mësimdhënësit që gjithë kohës hulumtojnë në internet për përgaditjen e njësive mësimore janë më pak se gjysma apo 41%, një pjesë më e madhe e tyre 48.3% e tyre përdorin aplikacione për pregaditjen e prezentimeve si dhe ushtrime dhe detyra për nxënës. Poashtu, më pak se gjysma e tyre vlerësojnë dhe kthejnë informata kthyese nxënësëve të tyre. Aftësitë teknike apo në përdorimin e TIK nga ana e mësimdhënësëve janë shumë të rëndësishme. Se a ndjehen të sigurtë mësimdhënësit gjatë punës me TIK, kemi gjetjet si më poshtë. Shumica prej tyre dinë të përdorin procesorët e tekstit, excelin dhe powerpointin. Përdorimin e emaileve për komunikim e bëjnë nganjëherë 80% e tyre, si dhe në shkarkimin e aplikacioneve dhe përdorimin e platformave online janë të sigurtë shumica prej tyre.

Këto edhe pse shifra jo shumë të ulta prap se prap janë tregues që shumica e mësimdhënësëve nuk e përdorin potencialin që ka TIK- për të kontribuar në cilësinë e mësimdhënies e të mësuarit dhe duhet gjendur mënyra që mësimdhënësëve të i'u ofrohet ndihma e nevojshme në mënyrë të vazhduar për përdorimin e TIK-ut, për përzgjedhjen e sistemeve për menaxhimin e mësimit të përshtatshme, pasi që teknologjia ndryshon çdo ditë dhe atë në mënyrë eksponenciale. Mbështetje kjo që përdorimi i teknologjisë mos të jetë stresues dhë të shkaktoj vetëm konfuzione, mirëpo mësimdhënësit të mund të ndjejnë lehtësirat që ofrohen, të ndjehen të motivuar dhe të ndërthurinë sa më mirë metodologjitë e punës me mundësitë ekzistuese të teknologjisë.

9.Përfundim

Në një botë që sa vjen e më shumë po orientohet drejt teknologjisë dhe globalizmit, kuptimi, përdorimi dhe krijimi i kulturës së Teknologjisë të Informacionit dhe Komunikimit është bërë një faktor shumë i rëndësishëm që mundëson arsimimin e nxënësëve me edukim më bashkëkohor, e aftësi për tu përballur me sfidat e zhvillimit. TIK ka përmirësuar procesin e të mësuarit nëpërmjet ofrimit të materialeve interaktive, edukative që rrisin motivimin tek nxënësit dhe lehtësojnë marrjen e aftësive bazë. Përdorimi i paisjeve multimediale të ndryshme, të tilla si televizor, video dhe aplikacionet kompjuterike ofrojnë një ambient më sfidues dhe angazhim më të madh për të gjithë nxënësit. Infrastruktura e nevojshme kërkon kosto shtesë për institucionin, por do të mjaftonte edhe një kompjuter dhe projektor i vetëm në klasë, dhe do të mund të transformoheshin praktikat tradicionale të të mësuarit, me mësuesin në qendër si burim i vetëm i dijes dhe informacionit, në praktika moderne me nxënësit në qendër, me rritjen e angazhimit, kreativitetit, mendimit kritik dhe performancës në përgjithësi.

Qëllimi i këtijë studimi është që të hulumtoj impaktin e ekspozimit të nxënësëve në TIK në performancën e tyre apo vërtetimi i hipotezave të mëposhtme:

4 Ekspozimi i nxënësëve në TIK ka shumë efekt pozitiv në procesin e mësimnxënies krahasuar me nxënësit e po të njëjtit vit që nuk janë të ekpozuar në te.

5 Qasja në burimet e ofruara nga TIK është shumë e rëndësishme në procesin e mësimdhënies dhe konrtibuon direkt tek mësimnxënia.

6 Përdorimi i metodave të ndryshme të TIK-ut në mësimdhënie nga ana e mësimdhënësëve ndikon direkt tek mësimnxënia.

Prej përvojës sonë mbi 10 vjeçare, shfletimit të literaturës, prej testimit eksperimentues në klasë si dhe nga pyetësori me nxënës, mendojmë që është mëse e qartë se hipoteza që : Ekspozimi i nxënësëve në TIK ka shumë efekt pozitiv në procesin e mësimnxënies krahasuar me nxënësit e po të njëjtit vit që nuk janë të ekpozuar në te, vërtetohet plotësisht.

Poashtu në lidhje me hipotezën e dytë, nga përvoja jonë, shfletimi i literaturës dhe duke shtuar rezultatet e marra nga pyetsorët e nxënësëve se ata i kuptojnë më mirë njësitë mësimore të ofruara me mbështetjen e TIK-ut, ndjehen më të motivuar në kryerjen e detyrave dhe ndjejnë që TIK-u ka përmirësuar rezultatet mësimore, janë tregues shumë i qartë që edhe hipoteza e dytë vërtetohet plotësisht.

Rezultatet e marrura nga pyetsorët me mësimdhënës, sygjerojnë që ata ndjehen mjaft të motivuar në përdorimin e teknologjisë, e përdorin atë për hulumtime dhe përdorin

aplikacione për prezentimin e njësive mësimore shumica prej tyre. Përgjigje këto të marra nga grupmosha relativisht të reja të mësimdhënësëve (me përvojë pune 5 deri 20 vjeçare), e që mund të llogariten te moshat që janë më të adaptueshëm dhe më lehtë i qasen teknologjisë, vërtetojnë edhe hipotezën e tretë. Hipotezë kjo që mbështetet jashtzakonisht shumë edhe nga shfletimi i literaturës përmes hulumtimeve dhe rasteve të studimit që janë të shumta e që janë përfshirë ose jo në këtë studim.

Comment [BR4]: Kete rregulloje. A kemi mesimdhënës te grupmoshës 5 vjeçare?!?!?!

Nga rezultatet e pyetsorëve dhe përvoja personale mendojmë që mbështetja për mësimdhënës është shumë e nevojshme dhe përbën një sfidë në vete. Praktikat nga trajnimet e detyrueshme, me përmbajtje të kufizuar dhe me kohëzgjatje të shkurtër nuk janë treguar adekuate për të qenë në hap me ritmet e zhvillimit teknologjik. Mbështetja duhet të jetë e vazhdueshme dhe në hap me trendet e zhvillimit dhe duhet të kërkohet në radhë të parë brenda vetë institucionit, duke ndërruar praktikat e punës individuale dhe politikat e planifikimit. Shqyrtimi i literaturës sygjeron që komponent kyç është plani i rritjes profesionale i shkruar nga çdo mësimdhënës duke i ndjekur udhëzimet e dala nga drejtoria apo ministria e arsimit. Dhe ky plan do të duhej të fillonte me vendosjen e objektivave: çka u duhet nxënësëve të dinë dhe çka do të jenë në gjendje të bëjnë? Pastaj bëhet zgjedhja e teknologjive që mbështesin këto objektiva, si do të përdoren këto teknologji dhe vlerësohet efikasiteti i tyre. Më tej strategjia e zhvillimit profesional të mësuesve rekomandon mbledhjen në grupe të mësuesve në mënyrë që të shkëmbehen njohuritë, atëher kur janë të nevojshme dhe në kohën e duhur, vizita të jashtme dhe pjesmarrje në konferenca në mënyrë që të mund të krahasohen praktikat që përdoren dhe eventualisht të gjenden ato më të mirat. Praktikimi i të mësuarit online duhet të shfrytëzohet nga mësimdhënësit për rritjen e zhvillimit profesional në përgjithësi dhe shtimin e aftësive për përdorimin e teknologjive në veçanti. Sistemet e menaxhimit të të mësuarit kanë potencial të konsiderueshëm për të zgjeruar mjedisin arsimor. Në këtë rrugë të zhvillimit do të ketë ngarkesa shtesë për mësuesit, megjithatë përmirësimet e nevojshme dhe të dëshiruara asnjëherë nuk vinë pa rritur përpjekjet. Zgjedhja e një LMS sistemi në dispozicion është një proces kompleks dhe që kërkon kohë dhe përpjekje në mënyrë që të gjendet sistemi më i përshtatshëm i cili do të përmbushte kërkesat specifike të institucioneve e në rastin tonë në institucionet e edukimit. LMS duhet të jetë një produkt i zgjerueshëm që mund të shkallëzohet për të mbajtur ritmin me me regjistrimet në rritje, duhet të jetë një një zgjidhje komplet e adaptueshme që është fleksibile dhe e mjaftueshme për të përmbushur nevojat unike të institucionit.

Referencat

Adel Ben Youssef, Mounir Dahmani. (2008). The Impact of ICT on Student Performance in Higher Education: Direct Effects, Indirect Effects and Organisational Change

Tezci, E. (2011). *Factors that influence preservice teachers' ICT usage in education*. European Journal of Teacher Education

Biggs, J. B. (2003). *Teaching for quality learning at university.* 2nd edn. *Buckingham: Society for Research into Higher Education & Open University Press*

IEEE Learning Technology Standards Committee (LTSC) (2001). *Draft Standard Technology Systems Architecture (LTSA)*, Draft 9, [http://ltsc.ieee.org/]

Brush, T., Glazewski, K. D. and Hew, K. F. (2008). Development of an instrument to measure preservice teachers' technology skills, technology beliefs, and technology barriers

Castro Sánchez, J. J. and Alemán, E. C. (2011). *Teachers' opinion survey on the use of ICT tools to support attendance-based teaching.* Journal Computers and Education, vol. 56, pp.911-915.

Blurton,C. (2002). *New Directions of ICT-Use in Education*. [http://www.unesco.org/education/educprog/lwf/dl/edict.pdf;accessed]

Willem Pelgrun,Nancy Law. (2003). ICT in education around the world: trends, problems and prospects

Musai,B. (2003). Metodologjia e mësimdhënies. Tiranë :CDE,fq.11.

Rama, B. (2011). Metodat e mësimdhënies dhe ndikimi i tyre në të nxënë." Revista pedagogjke".Tiranë:fq.27,fq.30

Mary Burns. (2010). *How to Help Teachers Use Technology in the Classroom The 5J Approach*

Jennifer Lyn Flanagan. (2008).Technology :The Positive And Negative Effects On Student Achievement

Arif Sarı. (2013). Potential issues and impacts of ICT applications through learning process in higher education

C. SureshKumar. (2017). ICT in Teaching Learning Process for Higher Education: Challenges and Opportunities

Stella Nwigbo, Dr. Madhu B. (2016). *Impact of ICT on the Teaching and Learning Process*

A Case Study Of The Integration Of Information And Communication Technology In A Northern Ontario First Nation Community High School: Challenges And Benefits Gerald Laronde, Nipissing University, Canada Katarin MacLeod, St. Francis Xavier University, Canada Lorraine Frost, Nipissing University, Canada Ken Waller, Nipissing University, Canada

Sara Sharick. (2016). Case Study on How High School Teachers Incorporate Technology in the Classroom to Meet 21st Century Student Learning Needs ,Walden University

Blurton,C. (2002). New Directions of ICT-Use in Education. [http://www.unesco.org/education/educprog/lwf/dl/edict.pdf;accessed]

William R.Watson.(2012). An argument for Clarify What are LMS, What are thay not, and What Should that Become

Peter Berking, Shane Gallagher (2011). Choosing a Learning Management Systems

Brayant, Machao, Tao (2007). A Comparison of Learning Management Systems

Contact North (2012). Learning Management Systems in Ontario- Who's Using What

MASHT, (2012). Udhëzuez për projektimin e ndërtesave shkollore

Chi-Un Lei, Kaiyu Wan,Ka Lok Man. (2013). *Facilitating Teaching CPS and*

Technology-based Content with Learning Management

Comment [BR5]: Rregulloji dhe formatoji referencat mire.

Comment [H6]:

Shtojca 1: Pyetsor me mësimdhënës rreth përdorimit të TIK gjatë procesit mësimor

1. Ju jeni mësimdhënës i klasës së:

- ☐ Dhjetë
- ☐ Njëmbëdhjetë
- ☐ Dymbëdhjetë

2. Përvoja e juaj e punës është

- ☐ 5 deri 10 vite
- ☐ 10 deri 20 vite
- ☐ 20 e më shumë

3.Sa e përdorni kompjuterin dhe internetin ne klasen e juaj?

- ☐ Gjithë kohës
- ☐ Shpesh
- ☐ Nganjëher
- ☐ Rrallë
- ☐ Aspak

4. A e përdorni kompjuterin/internetin per aktiviteteve të mëposhtme

Përgaditjen e mësimeve Po ☐ Jo ☐

Gjatë mësimdhënjës në klasë Po☐ Jo ☐

5. Si është i disponueshëm TIK-u në klasat e juaja?

	asnjiherë	rrallë	nganjëherë	shpesh	gjithë kohës
Nxënësit janë të pajisur me kompjuterë	☐	☐	☐	☐	☐
Vetëm mësimdhënësit përdorin kompjuterë	☐	☐	☐	☐	☐
Nxënësit dhe mësimdhënësit përdorin kompjuterë	☐	☐	☐	☐	☐

6. A lejohën nxënësit e juaj të përdorin paisje personale si më posht?

	Po	Jo
Laptop, tablet	☐	☐
Mobila ose Smartphone	☐	☐

7. A është e detyrueshme pjesmarrja në trajnime të TIK-ut në shkollën tuaj?

☐ po
☐ jo

8.Sa shpesh ju i aplikoni aktivitetet e mëposhtme?

	asnjiherë	rrallë	nganjëherë	shpesh	gjithë kohës
Hulumtoni në internet për përgaditjen e njësive mësimore	☐	☐	☐	☐	☐
Përdorëni aplikacione për përgaditjen e prezentimeve të mësimeve	☐	☐	☐	☐	☐
Krijoni materialet e juaja digjitale mësimore	☐	☐	☐	☐	☐
Përgaditni ushtrime dhe detyra për nxënës	☐	☐	☐	☐	☐

Vlersoni dhe ktheni informata kthyese nxënësëve	☐	☐	☐	☐	☐
Komunikoni online me prindërit	☐	☐	☐	☐	☐

9. Përdorimi i TIK-ut në klasë a ndikohet nga:

	Aspak	pak	pjesërisht	shumë
Numri i pamjaftueshëm i kompjuterëve	☐	☐	☐	☐
Pamjaftueshmëria e dijeve adekuate të mësimdhënësëve	☐	☐	☐	☐
Pamjaftueshmëria e përmbajtjeve/materialeve adekuate	☐	☐	☐	☐
Vështirësi në integrimin e TIK në kurrikulë	☐	☐	☐	☐
Interesimi i pamjaftueshëm i mësimdhënësëve	☐	☐	☐	☐

10. Sa jeni të sigurtë me sa vijon?

	Aspak	Pak	Jo shumë	Shumë
Shkruarja e tekstit përmes processorëve të tekstit	☐	☐	☐	☐
Përdorni emailin për komunikime	☐	☐	☐	☐
Përdorni Excelin	☐	☐	☐	☐
Krijoni prezentime me animacione	☐	☐	☐	☐

të thjeshta

Shkarkoni dhe instaloni softwer në kompjuter	☐	☐	☐	☐
Përdorni platforma për mësim online	☐	☐	☐	☐

11.Sa ndjeheni të motivuar në përdorimin e TIK në mësimdhënie?

☐ Shumë

☐ Jo shumë

☐ Pak

☐ Aspak

12. A përdoren platforma për mësim online në shkollën e juaj?

☐ Po

☐ Jo

☐ Nuk e di

Shtojca 2: Pyetsor me nxënës rreth përdorimit të TIK gjatë procesit mësimor

1. Ju jeni nxënës i klasës:

☐ Dhjetë
☐ Njëmbëdhjetë
☐ Dymbëdhjetë

2. Gjinia e juaj:

☐ Femër
☐ Mashkull

3.Sa e përdorni kompjuterin dhe internetin ne klasen e juaj?

☐ Gjithë kohës

☐ Shpesh
☐ Nganjëher
☐ Rrallë
☐ Aspak

4.Unë e përdori Internetin për:

☐ Për komunikim

☐ Për kërkim të informacioneve

☐ Për argëtim

5.Unë e përdori Internetin

☐ Në shkollë

☐ Në shtëpi

6.Unë i përdori paisjet kompjuterike, aplikacionet dhe motorët e kërkimit:

☐ Çdo ditë

☐ 3 deri 4 ditë në javë

☐ 2 ditë ose më pak në javë

☐ Asnjëherë

7.Si ndiheni për përdorimin e teknologjisë në klasë

	Pajtohem plotësisht	pajtohem	nuk pajtohem	nuk pajtohem aspak
Më ndihmon përdorimi i teknologjisë	☐	☐	☐	☐
E evitojë përdorimin e teknologjisë kur të mundem	☐	☐	☐	☐
Mendojë që përdorimi i teknologjisë në klasë merr shumë kohë	☐	☐	☐	☐

Do të isha nxënës më i mirë nëse do të dija të përdor drejt teknologjinë ☐ ☐ ☐ ☐

Besoj që përdorimi i teknologjisë më ndihmon në përmirësimin e aftësive gjuhësore ☐ ☐ ☐ ☐

8.A ju lejohet përdorimi i smartphone/tablet personal në klasë?

☐ Po
☐ Jo

9.Sa është më e kuptueshme përmbajtja mësimore me përdorimin eTIK-ut?

☐ Shumë më e kuptueshme
☐ Më e kuptueshme
☐ Pak e kuptueshme
☐ Aspak e kuptueshme

10.A ndjeheni se TIK-u ka përmirësuar rezultatet e juaja në mësime?

☐ Po
☐ Jo

11.A mendoni se mësimdhënësit kanë njohuri dhe e përdorin drejt TIK-un në klasë?

☐ Shumë

☐ Mjaftueshëm

☐ Pak

☐ Aspak

12.A janë shpjegimet verbale të fotografive/grafikëve të përdorura më efektive se sqarimet e shkruara?

☐ Shumë më efektive

☐ Më efektive

☐ Më pak efektive

☐ Aspak efektive

13.A e pengon interaksionin me nxënës prezentimi në Power Point i përmbajtjeve mësimore?

☐ E pengon shumë
☐ Nuk e pengon shumë
☐ E pengon pak
☐ Aspak

14. A ka dështuar ndonjëherë teknologjia gjatë orëve mësimore?

☐ Shumë shpesh

☐ Jo shpesh

☐ Rrall

☐ Asnjëherë

15.Sa ndjeheni më të motivuar me përmbajtjet mësimore që ju ofrohen përmes TIK-ut?

☐ Shumë

☐ Jo shumë

☐ Pak

☐ Aspak

16. Sa e lehtë është përdorimi i platformave për mësim online?

☐ Shumë e lehtë

☐ Jo shumë e lehtë

☐ e lehtë

☐ aspak e lehtë

https://docs.google.com/forms/d/1f-18cgLfrd6qThChfN3UgUlBAmGqgrkKQ0FIePL1RQs/edit?usp=sharing -Linku i pyetsorit për mësimdhënës

https://docs.google.com/forms/d/1LYMgXQexkxmIwwXvFjvhdL_WONfUPTO7NHo_71Y0Ti8/edit?usp=sharing - Linku i pyetsorit për nxënës